

Emër Mbiemër: **KOSTA BARJABA**

Datëlindje: **02.08.1960**

Vendlindje: **Sarandë**

Viti i zgjedhjes: **2011 (akademik i asociuar)**
2017 (akademik)

Seksioni: **Shkencat shoqërore dhe albanologjike**

Gjuhët: **Anglisht, Italisht, Greqisht**



Kontakt

Adresa: **Rruga "Haxhi Dalliu", Pall. 196, Tiranë**

Telefon: **355 4 2256761**

E-mail: **kosta_barjaba@ksg05.harvard.edu**

Faqe zyrtare: **www.akad.gov.al**

CV e shkurtër

Personalitet i spikatur dhe një ndër themeluesit e sociologjisë bashkëkohore shqiptare. Studimet e larta i kreu në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politiko-Juridike, dega filozofi, ku u diplomua "Punonjës i shkencave politike". Në vitin 1989 fitoi gradën "Kandidat i shkencave" në Universitetin e Tiranës, në vitin 1995 gradën "Doktor i shkencave" dhe në vitin 1999 titullin "Profesor". Në vitin 2005 u diplomua "Master në administratë publike" në shkollën "Kenedi" të qeverisjes në Universitetin e Harvardit. Ka kryer kualifikime, studime dhe kërkime shkencore në disa universitete perëndimore, si: Universiteti "Brown", SHBA (2004); Universiteti i Miçiganit Lindor, SHBA (1998); Universiteti i Triestes, Itali (1997); Universiteti "Capodistria" i Athinës, Greqi (1996); Qendra Norvegjeze e Kërkimeve për Rininë, Oslo (1995); Universiteti i Regensburgut, Gjermani (1994) dhe Universiteti i Leçes e Universiteti i Trentos, Itali (1993). Gjatë viteve 1984–1993 ka punuar si pedagog i filozofisë dhe i sociologjisë në Universitetin e Tiranës. Në vitet 1993–1994 ishte koordinator për sociologjinë në grupin e ristrukturimit të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Gjatë viteve 1997–2004 dhe 2005–2008 shërbeu në detyra të larta shtetërore dhe politike në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe në Ministrinë e Financave, ndërsa gjatë viteve 2014–2017 si këshilltar në Ministrinë e Shëndetësisë. Gjatë

viteve 2009–2012 shërbeu si dekan i Fakultetit të Shkencave Politike në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë dhe gjatë viteve 2013–2014 si pedagog i sociologjisë dhe i politikave publike në Universitetin European të Tiranës. Ka botuar mbi 15 libra dhe dhjetëra artikuj shkencorë, brenda dhe jashtë vendit, dhe ka referuar në mbi 100 veprimtari shkencore ndërkombëtare për temat e mësipërme. Është anëtar i redaksisë së sociologjisë dhe hartues i disa zërave të sociologjisë në "Fjalorin enciklopedik shqiptar", 2008–2009. Disa nga librat e tij përdoren si tekste mësimore në disa universitete italiane, si: Universiteti "La Sapienza", Romë; Universiteti i Milanos "Bicocca"; Universiteti "Frederiku II", Napoli; Universiteti i Barit; Universiteti "Fisciano", Salerno dhe Universiteti i Salentos. Me veprimtarinë e tij intensive dhe produktive mësimdhënëse, kërkimore-studimore e botuese, Kosta Barjaba ka dhënë dhe vazhdon të japë një kontribut të shquar në studimin dhe ndriçimin e mjaft aspekteve të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë gjatë dekadave të fundit.

Publikime (monografi, vepra kolektive, përmbledhje studimesh)

2017

- ***Rimodelimi i zhvillimit në kontekstet lokale.*** Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

2016

- ***Asimetritë e zhvillimit si shkak i varfërisë,*** Akademia e Shkencave e Shqipërisë; UET Press, Tiranë.

2015

- ***Migrimi i varfërisë,*** Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

2014

- ***Rithemelimi i mirëqenies, zhvillimi sfidant i varfërisë.*** Tiranë, UET Press, ISBN 978-9928-4193-9-2.
- ***Transnational Networks, Transnational Entrepreneurship and the Role of the State: the Cases of Serbia and Albania.*** Belgrade: Group 184; ISBN 978-86-86001-62-7.

2013

- ***Kurthet e papunësisë.*** Tiranë, UET Press. ISBN 978-9928-4182-2-7.

2012

- ***21 Janari, një histori e papërfunduar.*** (me bashkautor) Tiranë, Toena, ISBN 978-99943-1-794-3.

2011

- **Elita demografike në tranzicionin demografik. Rinia si përvojë sociologjike.** Tiranë, Toena; UMSH Press, ISBN 978-99943-1-734-9.
 - **As lokale, as kozmopolite? Emigrimi si përvojë sociologjike.** Tiranë, Toena; UMSH Press, ISBN 978-99943-1-735-6.
 - **Bazat e sociologjisë (me bashkautor), (Foundations of Sociology).** Tiranë, Toena, ISBN 978-99943-1-705-9.
- 2010
- **Hyrje në Sociologji.** Tiranë, Sh.b. "Naimi", ISBN 978-9928-4017-0-0.
- 2004
- **Albania's Democratic Elections.** 1997–2001, Berlin, Edition Sigma, ISBN 3-89404-237-0.
- 2003
- **Shqiptarët. Këta ikës të mëdhenj.** Tiranë, Korbi, ISBN 99927-788-7-3.
- 2002
- **Ondate senza ritorno.** Rome, IOM, ISBN 92-9068-136-23.
- 2001
- **Rruga shqiptare e modernizimit** (me bashkautor) Milano, Franco Angeli,
- 1997
- (a cura di) **Albania. Tutta d'un pezzo in mille pezzi.... e dopo?** FUTURIBILI, 2–3, 1996, Milano, Franco Angeli.
- 1996
- **Nafragi Albanesi** (me bashkautor) Roma, Sensibili alle Foglie, ISBN 88-86323-17-4.
- 1995
- **Pauzat e integritit. Rinia në fokusin e sociologjisë.** Tirana, Sh.b. Europa.
 - **Njohuri për shoqërinë** (me bashkautor) (Tekst për shkollat e mesme), Tiranë, SHBLSH.
- 1994
- **Sociologjia. Pas një mungese të gjatë.** (Shkrime sociologjike për jetën ushtarake), Tiranë, SHBLU.
- 1993
- **Njohuri për shoqërinë** (me bashkautor), (Manual në ndihmë të mësuesve), Tiranë, SHBLSH.
- 1990
- **Studentët dhe psikologjia e tyre shoqërore.** Tiranë, 8 Nëntori.